



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KRYETARI**

Nr. _____ prot.

Laç, më _____.____.2023

Shtojca 13

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data 13.01.2023

Drejtuar: Operatorit ekonomik “S.M.O.UNION” SHPK, **Adresa:** Shkoder Shkoder SHKODER BELTOJE.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” Punë (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-47733-10-27-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksion i rrugës, Lagje Nr.2 Laç, Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: **16,964,112** (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.149, datë 31.10.2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “S.M.O.UNION” SHPK, me numër NIPTI **J66902042Q**.
Vlera e ofertuar: **13,204,200** (trembëdhjetë milion e dyqind e katër mijë e dyqind) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “**AEK MUNELLA**” SHPK, me numër NIPTI **J98926001P**.
Vlera e ofertuar: 13,295,652 (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë **pa TVSH**.
3. Operatori ekonomik “**Rroku GUEST**” SHPK, me numër NIPTI **K87921701H**.
Vlera e ofertuar: 13,981,504 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e katër) lekë **pa TVSH**.
4. Operatori ekonomik “**DENIS-05**” SHPK, me numër NIPTI **K51518029B**.
Vlera e ofertuar: 15,758,400 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë **pa TVSH**.
5. Operatori ekonomik “**COMPANY RIVIERA 2008**” SHPK, me numër NIPTI **K81716011V**.
Vlera e ofertuar: 15,769,756 (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë **pa TVSH**.
6. Operatori ekonomik “**SHKELQIMI 07**” SHPK, me numër NIPTI **K68121808W**.
Vlera e ofertuar: 15,920,200 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e njëzet mijë e dyqind) lekë **pa TVSH**.
7. Operatori ekonomik “**SARK**” SHPK, me numër NIPTI **K52531415H**.
Vlera e ofertuar: 16,081,520 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet) lekë **pa TVSH**.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**Rroku GUEST**” SHPK, me numër NIPTI **K87921701H**.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/ vlefshme....."**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson pikën 2.3.3 të DST, si më poshtë:

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë *personelin kryesor, Drejtues Teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:*

1 (një) Inxhinier Ndertimi

1 (një) Inxhinier Gjeodet/topograf/makshajder

1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Për sejcilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqese, Kontratë pune e vlefshme, diplomë , dhe CV, si dhe duhet të jetë në Listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Korrik -Gusht –Shtator- 2022.

KVO konstatoi se: OE “Rroku GUEST” SHPK nuk plotëson kriterin e mësipërm për 1 (një) Inxhinier Hidroteknik.

Sqarojmë se OE ka deklaruar në (Formularin e vetëdeklarimit) Inxhinier Hidroteknik Z. Aldo Gega dhe Zj. Merita Kazazi.

Por KVO kansatoi se këto dy Inxhinierë nuk figurojnë në Licencën e shoqërisë si Drejtues Teknik, kriter ky i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **S.M.O.UNION” SHPK**, me adresë: Shkoder Shkoder SHKODER BELTOJE, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **13,204,200** (trembëdhjetë milion e dyqind e katër mijë e dyqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kurbin, adresa: Lagjia Nr.3, Laç (në zyrën e protokollit të Bashkisë Kurbin), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **13,295,652** (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë **pa TVSH**, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

JO (Nuk ka patur)

**Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA**